



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:231332

Datë: 24.06.2024

Numri i dokumentit: 05850719

2021:231332

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Driton Ahmeti dhe me bashkëpunëtorin profesional F.H., në çështjen juridike kontestimore të paditësit Be.B. nga fshati R., Komuna Shtime, të cilin me autorizim e përfaqëson Islam Gashi avokat nga Lipjan, kundër të paditurës Komuna Shtime – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, jashtë seancës gjyqësore, më datë 24.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit B.B. nga fshati R., Komuna Shtime, si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Komuna Shtime – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.B., në emër të diferencës së papaguar të të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për 29 muaj të periudhës kohore prej datës 28.09.2018 deri më datë 21.01.2021, t'ia paguaj diferencën prej 60.25 € për çdo muaj, apo shumën e tërësishme prej 1,747.25 € (njëmijë e shtatëqind e dyzetë e shtatë euro e njëzetë e pesë cent) me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 134.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET paditësi që paraprakisht të paguaj taksën gjyqësore shtesë për paraqitje të padisë, në shumë prej 10.00 €, menjëherë pas pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbaramit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi B.B. përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate më dt.15.10.2021 ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna Shtime – Drejtoria Komunale e Arsimit, me kërkesën për pagesën e diferencës së të ardhurave të papaguar nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit shkollor – licencimit, për periudhën nga data 28.09.2018 deri më datën 21.01.2021 bazuar në dispozitat ligjore të Kontratës Kolektive në Arsim, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e arritjes për pagesë të secilës kërkesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës aq sa ato do të llogariten nga gjykata, të gjitha në afat prej shtatë ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E paditura brenda afatit ligjor e ka paraqitur përgjigjen e saj në padi, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se kërkesat e paditësit bazohen në Marrëveshjen Kolektive e cila nga data 17.04.2020 më nuk është në fuqi. Më tej e paditura ka theksuar se kërkesëpadi e paditësit është parashkruar. Sa i përket shtesës mbi bazën e kualifikimit, ka theksuar se e paditura Komuna Shtime për të gjithë mësimdhënësit pa dallim ka zbatuar ligjet dhe udhëzimet administrative duke u'a bërë pagesën e kualifikimit dhe përvojës së punës sipas përgatitjes profesionale të çdo mësimdhënësi.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë Sh.M. “N.F.” në Shtime. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës së papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësit për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata përmes kontratës së punës nr.05/488 të datës 01.11.2020 e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, rezulton se kualifikimi i paditësit është i nivelit universitar Bachelor i Gjeografisë – Drejtimi arsimor, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma në emër të paditësit.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit Bachelor i Gjeografisë, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik) provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë

universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës nr.05/488 të datës 01.11.2020, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, i’a ka paguar shumën prej 63.68 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësi përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësi përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 123.93 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 60.25 euro në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit shkollor –licencimit për 29 muaj nga data 28.09.2018 deri më datë 21.01.2021, në shumë të përgjithshme prej 1,747.25 euro.

Lidhur me kundërshtimet e palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, ngase paditësi padinë e ka paraqitur më dt.15.10.2021 për kërkesat që kanë të bëjnë nga data 28.09.2018 deri më dt.21.01.2021, që nënkupton se paditësi ka parashtruar padi për kërkesat brenda afatit të paraparë ligjor prej tri (3) vitesh të përcaktuar me nenin 87 të Ligjit të Punës.

Nga sa u tha më sipër, bazuar në nenin 398 të LPK-së, lidhur me pikën 4 nënpika 3 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, si dhe nenit 382 LMD-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Për shpenzimet e procedurës, Gjykata e ngarkoi të paditurën, konform nenit 452 par.1 të LPK-së dhe atë si vijon: për tarifën e paraqitjes së padisë në gjykatë, shumën prej 30.00 €, ndërsa për përpilimin e padisë nga avokati, shumën prej 104.00 € konform tarifës së OAK-së.

Gjykata e detyroi paditësin që paraprakisht të paguaj taksën gjyqësore shtesë për paraqitje të padisë në gjykatë, konform nenit 12 par.1 të UA të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

2021:231332 më datë 24.06.2024

Gjyqtari,
Driton Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.